

Drejt një Buxheti për Qytetarët

Rishikim Gjnor i Buxhetit të Kosovës 2024

Hyrje

Buxhetimi i përgjegjshëm gjnor (BPGj) siguron që fondet po buxhetohen dhe shpenzohen për të adresuar nevojat e ndryshme të grave, burrave, djemve dhe vajzave, siç identifikohen përmes analizës gjnore. Sipas Ligjit të Kosovës Nr. 05/L-020 për Barazi Gjnore (LBGJ), BPGj përfshin integrimin gjnor në procesin buxhetor dhe “ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve” për të promovuar barazinë mes grave dhe burrave.[1] Integrimi gjnor përkufizohet si përfshirje e perspektivës gjnore në “planifikimin, miratimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e legjislacionit, politikave, programeve dhe buxheteve, në të gjitha fushat politike, ekonomike dhe ato sociale” me qëllim të avancimit të mundësive të barabarta për burrat dhe gratë.”[2] Moszbatimi i BPGj-së, siç parashihet me këtë ligj, përbën shkelje ligjore dhe i nënshtrohet sanksioneve.

Ky komentari analizon deri në çfarë mase Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës i kanë zbatuar obligimet ligjore për BPGj-në lidhur me Buxhetin e Kosovës për vitin 2024. Komentari fokusohet në linjat buxhetore për të cilat Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), anëtarët dhe partnerët e saj kanë dhënë rekomandime për buxhetin e vitit 2024, si dhe vlerëson se deri në çfarë mase janë zbatuar këto rekomandime.

Sfidat me Monitorimin e Shpenzimeve Buxhetore në drejtim të Barazisë

Proceset transparente buxhetore janë thelbësore për të garantuar llogaridhënien e qeverisë dhe për të nxitur besimin e publikut. Buxhetimi programatik mund të rrisë transparencën duke mundësuar të kuptuarit më të saktë të burimeve të alokuara për avancimin e barazisë gjnore. Megjithatë, Kosova përdor linjat buxhetore të ndara sipas zërave në vend të buxhetimit programatik, gjë që paraqet vështirësi në përcaktimin e shumës së buxhetit të ndarë për barazi gjnore si dhe për vlerësimin e kontributeve të shpenzimeve të bëra për barazinë gjnore.

Transparenca dhe Llogaridhënia

Projektligji për Buxhetin e vitit 2024 asnjëherë nuk është vënë në dispozicion për konsultime publike pavarësisht se kjo kërkohet me Rregulloren (QRK) nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik. Pas miratimit të projektligjit nga Qeveria e Kosovës me datë 31 tetor 2023, RrGK ka dërguar “Analizën Gjnore të Përsheptuar të Projektligjit për Buxhetin e vitit 2024 me Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës”, duke kërkuar nga të gjithë deputetët e Kuvendit që të ndryshojnë projektligjin në mënyrë që të adresohen nevojat e ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve siç u theksua në analizë.

[1] Neni 3, paragrafi. 1.17


[1] Neni 3, paragrafi. 1.16.

Qeveria nuk ka publikuar shtojcat buxhetore, të cilat Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kërkon që çdo organizatë buxhetore (p.sh. ministritë dhe komunit) t'i përgatisë, sipas Qarkores Buxhetore. Ligji nr. 08/l-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 nuk u shoqërua me ndonjë deklaratë gjinore të publikuar që do të shpjegonte se si buxheti kontribuon në barazinë gjinore, edhe pse kjo do të ishte e rëndësishme duke pasur parasysh se Kosova përdor buxhetimin e linjës së ndarë sipas zërave. As nuk është e qartë nëse buxheti është krijuar në bazë të analizës gjinore. Prandaj, bazuar në Ligjin për Buxhetin, për qytetarët është e paqartë se si do të kontribuojë buxheti në qëllimet e Kosovës për avancimin e barazisë gjinore. Për më tepër, meqenëse këto shtojca nuk janë publikuar, qytetarët nuk mund t'i analizojnë për të vlerësuar nëse ato përmbushin në mënyrë adekuate nevojat prioritare.


Pasqyrë e trendeve dhe alokimeve buxhetore

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit në vitin 2024 janë planifikuar të jenë rreth 3.3 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 3%, ose rreth 91.3 milionë euro më shumë se në vitin 2023. Në kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëditje, ka një rritje prej rreth 59 milionë euro (8%). Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ka një rritje prej rreth 25 milionë euro (6%), ndërsa ka pasur rënie në shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere prej rreth 37 milionë euro (3%).

Grafiku 1. Shpenzimet korrente të planifikuara sipas kategorisë buxhetore



Sipas sektorëve, buxheti për arsim është rritur për rreth 54 milionë euro (17%) krahasuar me vitin 2023. Në mënyrë të ngjashme, buxheti për shëndetësi është rritur për rreth 49 milionë euro (17%). Për sektorin e sundimit të ligjit, buxheti është rritur përafërsisht 14 milionë euro (17%) krahasuar me vitin 2023. Buxheti për politikat sociale dhe pensionet është rritur dukshëm, duke arritur shumën prej rreth 756.5 milionë euro, që është përafërsisht 103.7 milionë euro (16%) më shumë se në vitin 2023. Sektori i mbrojtjes dhe sigurisë ka pasur gjithashtu një rritje buxheti prej rreth 50 milionë euro (21%), kurse buxheti i sektorit të kulturës dhe sportit është rritur për afërsisht 31 milionë euro (55%).



Integrimi Gjinator

Për buxhetin e vitit 2024 nuk ekziston ndonjë analizë e nevojave potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave, duke përfshirë burra dhe gra të moshave, etnive, aftësive dhe vendndodhjeve të ndryshme gjeografike. Ky buxhet as nuk është i shoqëruar me ndonjë deklaratë buxhetore gjinore për të shpjeguar se si shpenzimet do të kontribuojnë në arritjen e barazisë gjinore. Prandaj është e vështirë të kuptohen nevojat e ndryshme dhe si buxheti do t'i adresojë ato apo nëse do të kontribuojë në avancimin e mëtejshëm të barazisë gjinore.

Një linjë e rëndësishme buxhetore e lidhur me barazinë gjinore është paraparë për Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGj), në shumën totale prej 368,912€ në vitin 2024, krahasuar me 354,173€ në vitin 2023, duke treguar kështu për një rritje prej 4% në kategorinë për paga dhe mëditje. Megjithatë, nuk ka rritje të numrit të punëtorëve. Secila komunë ka një linjë buxhetore për pagat dhe mëditje për Zyrtarin/en për Barazi Gjinore, i/e cili/a ka përgjegjësi për të avancuar barazinë gjinore në nivelin komunal, për përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat lokale, për të ngritur vetëdijen për barazinë gjinore dhe për të zbatuar obligimet ligjore të përcaktuara në Programin për Barazi Gjinore, si dhe planet e veprimit për barazi gjinore në nivel kombëtar dhe atë komunal. Megjithatë, kjo linjë buxhetore e emërtuar “Çështjet Gjinore” është në buxhetin e vetëm 42% të komunave. Kjo ka pësuar rënie që nga viti 2023, ku 44% e komunave kanë pasur këtë linjë buxhetore. Në përgjithësi, shpenzimet e përgjithshme për këtë linjë buxhetore janë rritur për 4% (shih Shtojcën 1) dhe shuma mesatare e buxhetuar për një komunë është 18,196€. Megjithatë, shuma e buxheteve është ulur në disa komuna si komuna e Lipjanit dhe Skënderajit. Të gjitha komunat (38) kanë linjë buxhetore të ndarë për “Çështjet gjinore” në shumë të përgjithshme prej 691,448€. Mirëpo, disa komuna nuk kanë buxhet të ndarë dhe linja është bosh.

Vëmendja ndaj prioriteteve të barazisë gjinore

Ky seksion shqyrton se sa Ligji nr. 08/l-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 merr parasysh nevojat prioritare që janë identifikuar nga RrGK-ja, anëtarët dhe partnerët e saj, duke u bazuar në hulumtime dhe përvojë të gjerë. Rekomandime për adresimin e këtyre çështjeve prioritare i janë dhënë Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Ky seksion vlerëson se sa janë adresuar këto rekomandime.

Adresimi i dhunës me bazë gjinore

Në Ligjin për buxhetin e vitit 2024 nuk ka ndonjë ndryshim sa i përket ndarjeve buxhetore për Shpenzimet Bazë për Strehimoret për viktimat e dhunës në familje e që janë në shumë prej 1,5 milion euro. Kjo shumë mbulon kostot bazë të strehimoreve për gra dhe fëmijë. Buxheti gjithashtu parasheh ndërtimin e një strehimoreje në Ferizaj për gratë që kanë përjetuar dhunë. Buxheti për Zyrën e Mbrojtjes dhe Asistencës së Viktimave gjithashtu është rritur për 120,503€ (41%) në krahasim me vitin 2023, siç është rekomanduar, gjë që mund të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes për të mbijetuarit/at e dhunës me bazë gjinore. Edhe pse të gjitha këto shpenzime shënojnë përmirësime dhe janë të rëndësishme për avancimin e barazisë gjinore, buxheti i vitit 2024 nuk adreson disa shpenzime të parashikuara nga Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), e cila është pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke përfshirë:

- Një Qendër referimi për viktimat e dhunës seksuale ose Qendër për viktimat e përdhunimit (Konventa e Stambollit, neni 25) për trajtimin e të mbijetuarave të dhunës seksuale;
- Një linjë telefonike SOS, edhe pse kjo ishte paraparë në Protokollin e ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale
- Buxhetin e mjaftueshëm për të punësuar të paktën dy punonjës socialë të tjerë, veçanërisht për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në çdo komunë, në përputhje me përgjegjësitë e tyre institucionale në ligjin e ri nr. 08/l-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore. Kjo nuk reflektohet në kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëditje si pjesë e Grantit të Qeverisë për Shërbime Sociale. Këto pozita janë thelbësore për zbatimin e kornizës së re ligjore, për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e të mbijetuarave, kryesisht grave dhe fëmijëve.
- Edhe pse në vitin 2023 ka ekzistuar një linjë e veçantë buxhetore për trajtimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, në vitin 2024 kjo linjë buxhetore nuk ekziston. Kjo linjë buxhetore mund të jetë përfshirë në një kategori tjetër shpenzimesh, por një gjë e tillë është e paqartë.


Financimi adekuat i Skemës së Asistencës Personale

Buxheti i vitit 2024 nuk ka parasysh pagën minimale dhe kohën aktuale që kërkohet nga asistentët personalë për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara. Kjo kontribuon në shkeljen e të drejtave të punës së asistentëve personalë. Ekziston nevoja për të rritur buxhetin e alokuar për asistentë personalë të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë (PTTP) me shumë aktuale prej 150€ dhe për personat e verbër me shumë aktuale prej 125€, të përputhet së paku me pagën minimale (që aktualisht është 264€) apo idealisht të përputhet me pagën mesatare (që është 521€). Asistentët personalë shpesh punojnë më shumë se tetë orë në ditë për të ofruar kujdes dhe nuk u paguhet pensioni. Kjo përbën shkelje të të drejtave të tyre të punës sipas Ligjit të Punës. Gratë priren të jenë të mbipërfaqësuar në mesin e asistentëve personalë, kështu që adresimi i këtyre çështjeve mund të kontribuojë në përmirësimin e jetesës së tyre dhe atyre për të cilët ata kujdesen.

Duke marrë parasysh që në korrik të vitit 2023, kishte 2,737 persona PTTP dhe 1,858 persona të verbër, kjo do të kushtonte rreth 14,5 milionë euro për vitin 2024, që është afërsisht dyfishi i shpenzimeve të vlerësuara aktuale. Ndërkaq, buxhetimi i bazuar në pagën mesatare bruto do të kushtonte përafërsisht 28 milionë euro.

Buxheti për vitin 2024 përfshin rritje për disa kategori që prekin personat me aftësi të kufizuara. Në kategorinë “Pensionet e aftësisë së kufizuar” ka ndarje të buxhetit rreth 29 milionë, që është rreth 6 milionë euro (27%) më shumë në krahasim me vitin 2023. Në kategorinë “Skema e fëmijëve me aftësi të kufizuar 1-18” ka ndarje të buxhetit rreth 4 milion euro, që tregon për një rritje prej rreth 793,850€ (22%). Në kategorinë “Arsimi për fëmijët me nevoja të veçanta” ka ndarje të buxhetit për 2,9 milion euro, që paraqet një rritje prej afërsisht 443,586€ (18%). Për Institutin Special dhe shtëpinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara, buxheti për vitin 2024 është rreth 3.8 milion euro, një rritje e dukshme prej rreth 1,8 milion euro (97%). Megjithatë, nuk ka ndryshim në buxhetin për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe buxheti për këtë kategori mbetet rreth 11 milionë euro. Po ashtu nuk ka ndryshim në buxhetin për personat e verbër ku buxheti për këtë kategori mbetet rreth 52 milionë euro.

Grafiku 3: Ndarjet buxhetore për personat me aftësi të kufizuar



Mbështetja e Organizatave të Shoqërisë Civile

Deri më sot, organizatat e shoqërisë civile (OShC) kryesisht janë mbështetur në financimin ndërkombëtar, veçanërisht për monitorim, hulumtime dhe avokim. Buxheti i vitit 2024 mund të kishte përfshirë një linjë buxhetore të përhershme, adekuate për mbështetjen financiare të shoqërisë civile brenda çdo ministrie dhe komune, veçanërisht për ABGj. Ky financim mund të kishte mbështetur iniciativat e OShC-ve që synojnë avancimin e barazisë gjinore në përputhje me Programin për Barazi Gjinore. Financimi i qeverisë mund të përfshijë mbështetjen për hulumtim, rritjen e ndërgjegjësimit, avokimin, zhvillimin e politikave dhe monitorimin e shërbimeve shtetërore. Këto burime duhet të ndahen bazuar në udhëzimet e zhvilluara në konsultim të ngushtë me OShC-të për të garantuar drejtësi, transparencë dhe pavarësi të shoqërisë civile. Krijimi i kësaj mbështetjeje të vazhdueshme do të rriste qëndrueshmërinë afatgjatë të OShC-ve që mund të mbështesin Qeverinë në avancimin e barazisë gjinore. Qeveria nuk e ka pranuar këtë rekomandim për të vendosur një linjë të tillë buxhetore.

Adresimi i Ekonomisë Joformale dhe Avancimi i të Drejtave të Punëtorëve

Në Programin Qeverisës 2021-2025, mbrojtja e të drejtave të punëtorëve dhe përmirësimi i kushteve të punës, si dhe rritja e numrit të inspektorëve të punës është vendosur si prioritet gjë që nuk reflektohet në buxhetin e vitit 2024. Përkundrazi, Qeveria ka ulur buxhetin për Inspektoratin e punës për 14% në kategorinë e pagave. Ky reduktim i vë punëtorët në rrezik në një kohë kur nevojiten më shumë inspektorë, jo më pak, për të adresuar diskriminimin me bazë gjinore, ngacmimin seksual në punë dhe joformalitetin, që duket se prek gratë në mënyrë disproporcionale.

Rekomandimet

1.Të institucionalizohet BPGj në përputhje me zotimet ligjore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë edhe me Kornizën Plotësuese për Vlerësimin e Menaxhimit të Përgjegjshëm Gjinator të Financave Publike (PEFA GRPFM), dhe treguesin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara 5.c.1 (OBZH 5.c.1 e OKB-së):

- Të përfshihet fokusi ndaj BPGj-së në Ligjin e ardhshëm për Financat Publike si dhe të përfshihet në kërkesat e sistemeve të menaxhimit financiar digjital për të ofruar analiza gjinore, pikënisjet dhe objektivat për avancimin e barazisë gjinore në lidhje me shpenzimet e planifikuara buxhetore.
- Të kërkohet publikimi i shtojcave të barazisë gjinore nga ministritë dhe komunat me qëllim të transparencës dhe llogaridhënies.
- Të publikohet Deklarata Buxhetore Gjinore për të shoqëruar Ligjin për Buxhetin 2024 me qëllim të sqarimit se si shpenzimet do të kontribuojnë në barazinë gjinore, veçanërisht duke pasur parasysh që buxheti aktual në Kosovë i ndarë sipas zërave nuk e bën të qartë se si shpenzimet do të kontribuojnë në avancimin e barazisë gjinore.

2.Të ndahen fonde për avancimin e barazisë gjinore në komuna: Të sigurohet që çdo komunë të ketë buxhet dhe pagë të caktuar për Zyrtarin/en për Barazi Gjinore për të përmbushur obligimet ligjore.

3.Të adresohet dhuna me bazë gjinore:

- Ministria e Drejtësisë duhet të ndajë burimet e duhura për Qendrën për referimin e viktimave të dhunës seksuale ose Qendrën për viktimat e përdhunimit, si dhe për linjën telefonike SOS, që do të ofrojnë trajtim për të mbijetuarat e dhunës seksuale në përputhje me Konventën e Stambollit.
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Drejtësisë duhet të inkurajojnë fuqimisht komunat që të rrisin buxhetin për paga dhe mëditje, duke punësuar së paku dy punëtorë socialë shtesë në secilën komunë dhe katër në Prishtinë. Ata duhet të trajnohen, të çertifikohen dhe të punojnë në mënyrë specifike për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Kostoja shtesë është rreth 444,000€ dhe do të kontribuojë në zbatimin e kornizës ligjore, si dhe në zbatimin e Protokollit të ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.

4.Të rritet linja buxhetore për financimin e Skemës së Asistencës Personale në bazë të kohës aktuale që kërkohet nga asistentët personalë për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara. Kjo do të kushtonte rreth 14,556,960€, që afërsisht është dyfishi i shpenzimeve të vlerësuara aktuale.

5.Të ndahet linja buxhetore për OShC-të për të mbështetur hulumtimin, rritjen e ndërgjegjësimin, avokimin, zhvillimin e politikave dhe monitorimin e shërbimeve shtetërore, duke mundësuar kështu kontributin e tyre në avancimin e barazisë gjinore.

6.Të adresohen ekonomia joformale dhe të drejtat e punëtorëve: Të rritet buxheti për Inspektoratin e Punës, si dhe të rritet numri i inspektorëve të punës. Kjo do të mbështesë përpjekjet për të adresuar joformalitetin me një qasje të përgjegjshme gjinore dhe për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve, duke përfshirë të drejtat e grave për të punuar pa diskriminim dhe ngacim me bazë gjinore.

SHTOJCA 1: Buxheti i Komunave për Barazi Gjinore (Linja Buxhetore për Çështjet Gjinore)

Komuna	Çështje Gjinore 2023	Çështje Gjinore 2024	Diferenca	%	Numri i punëtorë ve 2023	Numri i punëtorë ve 2024
Deçan						
Dragash	9,907 €	11,200 €	1,293 €	13%	1	1
Ferizaj						
Fushë Kosovë	24,007 €	24,911 €	904 €	4%	2	2
Gjakovë						
Gjilan						
Drenas						
Graçanicë	10,924 €	11,760 €	836 €	8%	1	1
Han i Elezit						
Istog	23,000 €	29,535 €	6,535 €	28%	3	3
Junik						
Kaçanik	9,418 €	12,248 €	2,830 €	30%	1	1
Kamenicë	14,500 €	15,501 €	1,001 €	7%	1	1
Klinë	10,750 €	13,393 €	2,643 €	25%	1	1
Kllokot						
Leposaviq						
Lipjan	15,500 €		(15,500) €	-100%	2	0
Malishevë	19,621 €	19,621 €		0%	1	1
Mamushë						
Mitrovica Veriore						
Mitrovicë	39,290 €	44,380 €	5,090 €	13%	2	2
Novobërdë	12,100 €	13,600 €	1,500 €	12%	1	1
Obiliq						
Partesh	6,500 €	7,000 €	500 €	8%	1	1
Pejë	10,840 €	13,037 €	2,197 €	20%	1	1
Podujevë						
Prishtinë						
Prizreni						
Rahovec	7,308 €	8,964 €	1,656 €	23%	1	1
Ranillug	10,050 €	10,769 €	719 €	7%	1	1
Shtërpcë						
Shtime						
Skenderaj	38,881 €	36,880 €	(2,001) €	-5%	3	3
Suharekë						
Viti						
Vushtrri	16,824 €	18,338 €	1,514 €	9%	2	2
Zubin Potok						
Zveçan						
Gjithsej	279,420 €	291,137 €	11,717 €	4%	25	23



Për më shumë informacione ju lutem kontaktoni:

Elirjeta Beka

Kosovo Women's Network

E-mail: elirjeta@womensnetwork.org

